



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 117

Prishtinë, më 17.6.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Salih Morina, Daut Haradinaj.

Munguan : Liburn Aliu, Nijazi Idrizi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.5.2013,
3. Shqyrtimi i vërejtjeve me MMPH në Projektligjin për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Ndërtesave në Bashkëpronësi,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u shtua për “Të ndryshme” shqyrtimi i dy kërkesave.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.6.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 3.6.2013.

3. Shqyrtimi i projektligjit për ndërtesat në bashkëpronësi

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe kërkoi që përfundimisht të shqyrtohen vërejtjet dhe sugjerimet për këtë projektligj duke marr parasysh komentet nga MMPH por edhe të projektit në krye me Bill Donovan. Gjatë shqyrtimit dhe komenteve të bëra Kryetari **Nait Hasani** falënderoi posaçërisht angazhimin e udhëheqësit të projektit z. Donovan (i cili poashtu tha se ndihet i privilegjuar që ka mund të ndikoj pozitivisht) që ka kontribuar që ky projektligj të rregullohet me standarde të duhura, gjithashtu falënderoi zyrtarët e MMPH. Kryetari konstatoi se janë plotësuar vërejtjet e bëra nga Komisioni për Legjislacion duke bërë disa riradhitje të krerëve, në bazë të sugjerimit të MMPH, ndaj me një votim formal ftoi komisionin për vendimin si në vijim :

P Ë R F U N D I M

Pasi të bëhet riradhitja e disa krerëve në Rekomandimet e fundit të këtij Komisioni rreth këtij projektligji, sipas vërejtjeve nga Komisioni për Legjislacion, ashtu si është propozuar nga MMPH në mbledhjen e sotme, projektligji dërgohet në leximin e dytë.

4. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani njoftoi si vijon :

- rreth kërkesës së nënkryetarit Rasim Demirit i cili ka kërkuar ndryshimin e kohës së mbledhjes të hëneve për shkak se i njëjti merr pjesë në mbledhjet e kryesisë, komisioni vendosi që mbledhja të hëneve të mbahet prej orës 10,00,
- komisioni prej datës 25 qershor e tutje mund të vizitoi Kroacinë, por delegacioni mund të përbëhet nga 5 anëtarë të komisionit, ndaj komisioni u ftua që deri në mbledhjen e radhës të përfundojnë konsultimet rreth përbërjes së delegacionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani